




REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 20.09.2019, Nr. 09-111/01-55673



Në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr. 10/2018 të dt. 13/07/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Drejtori për Arsim, shpallë:

K O N K U R S

1. SHFMU „Fazli Greiçevci” në Vasilevë

- Një mësimdhënës për lëndën Edukimin Fizik, Sport dhe Shëndeti, deri sa të kthehet puntorja nga pushimi i lehonisë.

2. SHFMU „Bajram Curri” në Nekoc

- Një mësimdhënës për lëndën për Teknologji Informative, deri sa të kthehet puntorja nga pushimi i lehonisë.

3. SHFMU „Shotë Galica ” në Abri të Epërme

- Një mësimdhënës për lëndën Biologji-Kimi.

4. SHFMU „Rexhep Gjeli ” në Likoshan

- Një mësimdhënës për lëndën e Teknologjisë më Informatikë – 8 orë, SHFMU” Mehmet Gradica”- Gradica-8 orë, SHFMU”Luigj Gurakuqi”- Sankos- 4 orë = 20 orë

5. SHML”GJ.K.Skënderbeu” në Drenas.

- Një mësimdhënës për lëndën e Psikologjisë , deri sa të kthehet puntorja nga pushimi pa pagesë.

6. SHMP”Fehmi Lladrovci”-Drenas

- Një mësimdhënës për lëndën e Kimisë , deri sa të kthehet puntorja nga pushimi i lehonisë.

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.10 / 2018.

P.S: Të gjithë kandidatet të cilët nuk janë me përgatitje adekuate, sipas udhëzimit administrativ të lartcekur, nuk do të shqyrtohen aplikacionet e tyre, përjashtimisht në mungesë të kandidateve me kualifikim përkatës do të shqyrtohen aplikacionet me kualifikim më të përafërt.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma origjinale, ose Çertifikatën origjinale e diplomimit- jo më të vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar ne Komunë - Noteri publik.
4. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më të vjetër së gjashtë muaj.
5. Vërtetim i përvojës së punës vetëm ne arsim.
6. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur me çështjen e punësimit, për kandidatët që pranohen në punë.
7. Kopje të Çertifikatave të trajnimeve përkatëse (nëse keni)

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim dhe më gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do të bëj Komisioni i përzgjedhur nga DKA.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurrim merret në zyrat e DKA-së, G-11, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurrimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas, më: 20.09.2019.

